



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A.nr. 415/2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 12.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**MIRATOHET** si e bazuar ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR).

Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 4250 (katërmijedyqindesdhjet) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Më datë 10.12.2010 PZAP ka pranuar një ankesë nga subjekti politik AKR, në të cilën pretendohet se kandidatja e subjektit politik LDK, konkretisht Nekibe Kelmendi, me datë 09.12.2010 në rrugën Bajram Kelmendi në Prishtinë ka mbuluar me posterat e saj, posterat e kandidatit për deputet nga Koalicioni për Kosovën e Re Basri Lushtaku, duke shkelur në këtë mënyrë nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullën Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë se posterat e kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Nekibe Kelmendi, nga radhët e subjektit politik LDK, është vendosur mbi posterat e kandidatit të Koalicionit për Kosovën e Re. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

### **Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:**

PZAP-i e informoi subjektin politik LDK, më datë 11.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 12.12.2010, gjerë në ora 12:00.

PZAP-i, më datë 12.12.2010, pranoi përgjigje në ankesë nga subjekti politik LDK, në të cilën theksohet se për LDK-në një gjë e tillë është e papranueshme, për arsye se

“vendosja e posterit të kandidatit të LDK-ës mbi posterin e kandidatit të AKR-ës nuk është e qartë nga kush është bërë, pasi qe edhe për ne është e panjohur nga kush është vendosur posteri”. Më tej parashtruesi në përgjigje në ankese thekson se “i kemi njoftuar simpatizantët tanë për rregullat ligjore për vendosjen e posterave dhe për largimin e posterave, nëse vërejmë se janë vendosur një mbi një. Prandaj propozoj qe ankesa të refuzohet si e pabazuar”.

### **Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike**

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsi në vijim:*

*a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;*

### **Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve**

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

*Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:*

*c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetë mijë Euro (€50,000).*

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

Nga shkresat e lëndës rrjedh se poster i kandidates për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Nekibe Kelmendi, nga radhët e subjektit politik LDK, është vendosur mbi posterin e kandidatit nga Koalicioni Kosova e Re. Gjithashtu, duke u bazuar ne lendet e mëparshme, PZAP-i vlerëson se LDK, shkeljet e kësaj natyre i ka përsëritur në vazhdimësi, rrjedhimisht konsiderohet si recidivist, rrethanë e cila ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar me gjobë. Prandaj per këto arsye dhe më qëllim të evitimit të shkeljes së lartcekur si dhe në pajtim me dispozitat e lart cekura ligjore, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 415/2010 më datën 12.12.2010

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**

